



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8578 /2021
Data: 02.11.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e nëntë -IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28.10.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Edon Curri (Drejtor i Administratës), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hani të Elezit.
3. Buxheti i komunës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024.
4. Draft plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.
5. Kërkesa e z. Sherif Lusnjani për ndërrim destinim të pronës.
6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- nga data tetë prill deri më datë njëzet e gjashtë shtatorë janë administruar 6185 vaksina dhe prej tyre janë 3954 qytetarë të cilët janë vaksinuar vetëm me një dozë të vaksinës dhe 2231 të cilët janë vaksinuar me dy doza të vaksinës. Është punuar edhe gjatë ditëve të vikendit për dhënie të vaksinave sipas vendimit dhe kërkesës së Ministrisë përkatëse. Në sektorin e vaksinimit kemi punuar vetëm me një ndërrim për shkak të mungesës së mjekut. Janë kryer mbi 1400 teste rapide përmes laboratorit që është në QKMF. Janë 287 pacientë të cilët i kemi pasur pozitiv dhe fatkeqësisht kemi pasur 3 raste të vdekjes, aktualisht i kemi 6 raste pozitive të cilët janë në vetë izolim dhe asnjëri prej tyre nuk është hospitalizuar.

Florim Shkreta thekson:- a keni ndonjë plan më konkret për fëmijët të cilët kanë filluar nëpër shkolla pasi që rasti ka qenë në Maqedoni që është shtyer vijimi i mësimit me një datë tjetër për shkak se ka pasur infeksion të madh të fëmijëve . A keni ndonjë plan nëse na ndodhë kjo gjë.

Sabedin Hasallari thekson:- sa vaksina janë dhënë fajzer dhe sa vaksina janë dhënë astra zeneka.

Medina Imishti thekson:- të gjitha punët të cilat janë kryer deri më tani në sektorin e shëndetësisë janë kryere në bazë të rekomandimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Institutit. Me që Ministria përkatëse ka marr vendim për fillimin e vitit shkollorë dhe është plani në nivel shtetërorë edhe sa i përket vaksinimit të fëmijëve por komunat nuk mundën me implementuar pa pasur ndonjë vendim nga Ministria e Shëndetësisë. Sa i përket pyetjes që parashtrroi z.Sabedin Hasallari llojet e vaksinave janë të ndara por aktualisht nuk i kam informacionet por në informatën të cilën do ta kemi në kuvendë për sektorin e shëndetësisë do ty paraqesë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

3. Buxheti i komunës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- buxheti është hartuar konformë qarkores buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave, jemi bazuar nga kërkesat e drejtorive komunale dhe kërkesat të cilat i kemi marr nga qytetarët gjatë debateve publike që janë mbajtur për buxhetin. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 është në shumë prej 2,759,758 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2023 janë në shumë prej 2,903,855 € dhe për vitin 2024 janë në shumë prej 3,039,398 €. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin 2022 sipas pikës një të këtij propozim vendimi, mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,378,411 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 86.18%, ndërsa nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 381,347 € apo 13.82%. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2022 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe shtesa 1,756,083 €, mallra dhe shërbime 385,975 €, shpenzime komunale 67,700 €, subvencione dhe transfere 80,000 € dhe shpenzime kapitale 470,000 €. Kemi mbajtur pesë takime me qytetarët nga data 24.08.2021 deri me datë 31.08.2021 , i kemi marr propozimet nga qytetarët dhe i kemi inkorporuar në listën e projekteve kapitale. Me datë një shtatorë kryetari i komunës e ka dorëzuar te kuvendi komunal buxhetin sipas afatit ligjorë dhe për pos kësaj kryesuesi i kuvendit të komunës ka mbajtur takim publik me datë 17.09.2021 me komitet konsultative, OJQ dhe me pjesëmarrës të cilët ishin prezentë. Kërkesat e qytetarëve i keni të bashkangjitur së bashku me materialin e buxhetit dhe për secilin propozim është dhënë përgjigje veç e veç të cilat i kemi inkorporuar në këtë projekt buxhet. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- në takim publik që është mbajtur me datë 17.09.2021 ka qenë një kërkesë e administratorit të lagjes Meliq për rregullimin e një fushe të vogël sportive por ndoshta teknikisht është harruar me u shënuar te propozimet por në takim publik është propozuar dhe kërkoj që edhe ky projekt të hyn në kuadër të projekteve kapitale.

Habib Thaçi thekson:- kur do të realizohet pagesa e shujtave për mësimdhënës që drejtori potencojë që është paraparë në këtë projekt buxhet .

Sead Vila thekson:- zona që lidhet me rrugën “Imri Curri” të jetë në fokus të prioriteteve sikur se janë edhe zonat e tjera të cilat janë me zonat kadastrale që bëjnë pjesë me zonën e parë urbane. Nuk e shohë të arsyeshme që një lagje me obligime më të mëdha të tatimit në pronë me mbetur ndonjë herë sekondare në investime për nevojat e qytetarëve. Në disa seanca e kam kërkuar çështjen e shportave siç janë vendosur në rrugë, apo mirëmbajtja t’i epet rëndësi sikur disa rrugëve këtu në qendër sepse edhe ajo rrugë është zonë kadastrale numër një dhe i kryen obligimet barbarë me zonat e tjera të cilat janë në kategorinë e parë. Sa i përket shujtave vazhdimisht kam potencuar që niveli qendrorë ta rregullon në mënyrë sistematike çështjen e kompensimit të shujtave dhe të udhëtimit por edhe çështjen e pagës jubilarë .

Hanumshahe Dibrani thekson:- nxënësit të cilët udhëtojnë nëpër shkolla profesionale në Ferizaj dhe në Kaçanik të ju paguhen shpenzimet e udhëtimit pasi që në komunën tonë nuk kemi shkollë profesionale. Të rregullohen dollapë të librave nëpër shkolla sepse çantat të cilët i bartin fëmijët janë shumë të rënda. Te rruga “Ismail Qemali” të rregullohet një pjesë e prronit që është pa rregulluar.

Mehmet Ballazhi thekson:- i lexova propozimet e qytetarëve të cilat janë dhënë por shumë nga propozimet ne kemi kërkuar që të jenë në projeksionet buxhetore dhe nuk ka hyrë. A i keni paraparë vetëm si pika apo mund të mbulohen me buxhet për shkak se buxheti nuk mund t’i mbulon këto shpenzime për këto pika të cilat i keni shënuar. Kërkoj sqarim sa i përket nënkalimeve dhe mbikalimeve që janë paraparë te autostrada.

Nora Xhoni thekson:- tabela 4.2 financimi i projekteve kapitale është planifikuar një pajisje digjitale Ekioska. Kërkoj informacion se për çfarë pajisje digjitale bëhet fjalë dhe ku do të vendoset.

Habib Thaçi thekson:- kërkoj që të vendosen disa pengesa në rrugën “Isen Suma” sepse paraqet rrezik për fëmijë shpejtësia e veturave. Të rregullohet trotuari prej urës që fillon te fshati Dimcë deri te pjesa e magjistrales në Han të Elezit sepse fëmijët lëvizin në shkollë. Kur planifikohen të furnizohen shkollat me tabela të mençura. Kërkoj që të bëhet një mbikalim te çerdhja te hekurudha pasi që ka një frekuentim të madh dhe e lehtëson rrugën e nxënësve të cilët udhëtojnë nga Lagjja Meliq dhe Lagjja Brava.

Rufki Suma thekson:- projektet të cilat janë planifikuar janë në suaza të buxhetit të komunës. Sa i përket rrugëz “Isen Suma” ka nevojë me u bërë riparimi i rrugës për shkak se është e dëmtuar gjatë punimeve që janë kryer nga kompania “Bektellenka” më shumë ka nevojë me u bërë riparimi i krejt rrugës dhe pastaj të mendohet se a ka hapësirë apo jo për me u bërë trotuari. Sa i përket vendosjeve të pengesave duhet të shikohet se sa është e lejueshme për shkak se kemi probleme në të gjitha fshatrat sepse disa qytetarë kërkojnë disa jo por duhet të bisedohet me kryetarët e këshillave të fshatrave. Shujtat e arsimtarëve i kemi planifikuar me buxhetin e vitit 2022 dhe është shënuar që më së largu deri në muajin prill dhe nëse alokohen mjetet më herët ne mund të i kryejmë pagesat. Çdo herë kemi potencuar se realizimit të projekteve më shumë duhet tu epet prioritet në zonat urbane e pastaj të realizohen projektet edhe në zonat rurale por ndoshta kemi pasur ndonjë problem te pronarët e tokave për shkak se ndonjëri prej tyre nuk ka pranuar që pronën e vetë më bërë rrugë. Për vitin 2022 është planifikuar që të vendosen kontinierë për mbeturinave edhe për gjatë rrugëve sepse e kemi donacionin nga Gizi që jemi shpërblyer për performancë të mirë. Në atë kohë kur është rregulluar procka në Lagje të re kemi dashur me u zgjeruar edhe më shumë por kemi pasur probleme me pronarët e tokave. U potencua nga parafolësit se lista e projekteve është e madhe duke marr parasysh buxhetin dhe i

kemi përfshij në listë për shkak se nëse një projekt nëse nuk e kemi në listën prioritarë edhe nëse paraqitet ndonjë donatorë nuk mundemi me realizuar se nuk e kemi në listë. Rregullimin e dollapëve për librat jemi duke e menduar për me bërë por shkolla fillore "Ilaz Thaçi" i ka dy ndërrime dhe është pak problem, ndërsa shkollat të cilat e kanë vetëm një ndërrim është mirë me provuar dhe me parë si po funksionon. Transporti i nxënësve në drejtime të ndryshme për në Kaçanik i paguajmë shpenzimet e udhëtimit për shkak se nuk kemi drejtime të zanateve dhe nuk mund të dalim jashtë Kaçanikut sepse mund të ketë kërkesa që dikush donë me shkuar në Prishtinë apo edhe diku tjetër e mund të krijohen probleme që besoj që nuk mund ta menaxhojmë. Vendorsen e Ekioskos e kemi planifikuar për shkak se kemi shumë kërkesa prej qytetarëve prej vendeve të ndryshme të Kosovë të cilët edhe ditëve të vikendit kanë kërkuar që tu epet ndonjë certifikatë e lindjes dhe ofiqari ka has në mirëkuptim dhe ju ka kryer punë por kjo varet prej sistemit se nëse nuk është aktiv nuk mund me lëshuar dokumentacion. Te lagjja Thaçi në fshatin Paldenicë është për një far nënkalimi qysh në atë kohë dhe variant të fundit e kemi pasur se nëse nuk bëhet mbikalim të paktën me ja krijuar një qasje të rrugës me automjete.

Sead Vila thekson:- çështja e pajisjes me libra shkollorë nuk është obligim i Ministrisë dhe shumica e nxënësve nuk pajisen me libra, një pjesë jo pse nuk kanë mundësi por nuk kanë interesim duke filluar nga vetëdija e vetëdijesimit të familjarëve dhe disa bëjnë lluks në shpenzime dhe nuk pajisen me libra. Nuk e di sa janë mundësitë me caktuar një fond për kategoritë që vijnë prej rasteve sociale, familjet e dëshmorëve, veteranëve, invalidëve dhe familjet të cilat nuk e kanë asnjë të punësuar. Mendoj që nuk është një kosto shumë e madhe dhe mund të kryhet përmes donatorëve në mënyrë që kjo kategori e fëmijëve mos me ngecur në procesin e edukimit dhe arsimimit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka ekzekutivi i ka analizuar mirë propozimet e qytetarëve dhe i ka dhënë arsyet se cilat hyjnë në planifikime buxhetore dhe cilat jo dhe në pako i hedh në votim edhe propozimet e qytetarëve dhe projekt buxhetin; rezultati i votimit ishte 11 për, 1 abstenim z. Mehmet Ballazhi (nga grupi parlamentar i PDK-së) . Prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit.

U MIRATUA BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2022 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2023-2024

4. Draft plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- janë zhvilluar të gjitha procedurat për draft planin, grupi punues ka mbajtur takim së bashku me ekzekutivin e komunës, të gjitha propozimet janë harmonizuar me draft planin e kuvendit të komunës për vitin 2022. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit.

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

5. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që të bëhet ndërrim destinim i pronës për 150 m² . Konsulta kam pas me zyrtarët e drejtorisë së urbanizmit të cilët kanë potencuar se është në zonën ku lejohen ndërtimet dhe nuk është në kundërshtim me ligjin dhe lejohet ndërtimi. Komisioni ka dal në vend ngjarje dhe ka dhënë mendimin e tyre.

Habib Thaçi thekson:- është mirë që të shikohet çështja e klasës së pronës se mund të paraqet problem sepse diku është shënuar livadh i klasit gjashtë e diku i klasit pestë.

Zaim Bela thekson:- raporti i komisionit është paraqitur por fleta poseduese e paraqet komplet sa ka sipërfaqe dhe pjesa tjetër e fletës poseduese e ndanë livadh dhe arë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E SHERIF LUSNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Teuta Shkreta thekson:- nxënësit e moshës gjashtëmbëdhjetë dhe mbi, a i kanë testet serologjike.

Habib Thaçi thekson:- edhe pse mësimi ka filluar me vonesë kemi mungesë të librave të klasës së gjashtë dhe të nëntë dhe është mirë me bërë presion në organet përkatëse që me i furnizuar nxënësit me libra. Duhet të konsultoheni me inspektoratin që lokalet të cilat janë afër shkollave me ua ndaluar shitjen e pijeve energjike.

Sead Vila thekson:- drejtorja e arsimit a ka menduar edhe për planin B , nëse kemi ndonjë mësimdhënës me kovid a kemi mësimdhënës rezervë.

Menduh Vlashi thekson:- sa i përket pyetjes që parashtror znj. Teuta Shkreta nuk kam shënime por teste kanë bërë ata të cilët kanë qenë të dyshuar. Mësimdhënësit të gjithë janë vaksinuar me përjashtim i kemi dy apo tre të cilët ishin me kovid dhe nuk ua kanë dhënë vaksinën. Në bazë të informatave që kam klasat e nënta, gjashta dhe të shtata u mungojnë disa tekste por do të interesohemi për këtë çështje me Ministrinë. Çështjen e lokaleve për rreth shkollave e kemi ngritur shpesh këtë çështje por është problem i inspektorëve. Mësimdhënës rezerve nuk kemi për shkak se Ministria e Financave nuk na lejon me shtuar numrin e punëtorëve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sabedin Hasallari thekson:- këtë kërkesë e kam parashtruar disa herë që të depoja ime me i vendosur disa barriera në rrugë për shkak se po vozisin shumë shpejtë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:02

Procesmbajtësi

Azmi Bushi

